



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – SUHAREKË

Nr. Protokollit	06/ 2023
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	19.12.2023

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSBB” – Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSBB).

Takimi filloi në ora 10.00

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë
Halim Shehu - përfaqësues i Komunitetit Islam
Albert Demaj - përfaqësues i Komunitetit Katolik
Agim Bylykbashi- Drejtorja e Shërbimeve Publike, Siguri dhe Emergjencë
Fetije Bytyqi - përfaqësuese e EVSB-së
Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Albestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së
Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së
Adem Derguti - Kryetar i KPAK-së
Rozeta Jahaj - përfaqësuese e OJQ-së
Refki Zogaj - përfaqësues i komunitetit të biznesit
Eurolinda Zenelaj - përfaqësuese e mediave lokale
Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së
Qëndresa Baftjaraj - përfaqësuese e KPAK-së
Myrrete Shala - përfaqësuese e Shqiptarëve
Denis Sofra - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li
Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve
Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryetari i Komunës i cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;**
- 3. Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;**
- 4. Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tonë përdorin substanca narkotike;**
- 5. Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesve;**

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;

Kryetari - e hedhë në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sugurisë në territorin e Komunës;

Kryetari - ia jep fjalën komandantit të policisë.

Bashkim Gashi - situata e sigurisë në Komunën e Suharekës në bazë të vlerësimeve profesionale të policisë konsiderohet e qetë dhe stabile. Bashkëpunimi është shumë i mirë me të gjitha sferat qeveritare dhe jo qeveritare në nivel të Komunës së Suharekës, gjë që ne do të vazhdojmë ta forcojmë bashkëpunimin.

Halim Shehu - I përshëndesim policinë e Suharekës për ngjarjet e fundit që kanë ndodhë. I përgëzojmë por le të jenë më vigjilent dhe më të organizuar nëse është mundësia.

Kryetari - edhe unë si Kryetar i Komunës apeloj te policia të kenë kujdes e sidomos te sheshi pasi që presim një numër shumë të madh të diasporës. Mbrëmë e kemi thirr policinë dhe e kemi ndal muzikën në orën 9 në shesh. Le të mirren vesh që të jetë një muzikë e qetë sepse përndryshe ne duhet të marrim masa. Sa i përket mjeteve piroteknike e dini që çdo vit e kemi problem por deri sa dikush i lejon me hy dhe paguajnë dogana, ne edhe me dashtë s'mund ti ndalim andaj duhet me caktu një lokacion për shitjen e tyre dhe të jetë nën kontrollin e policisë. Ju uroj festat e fundvitit të gjithëve .

Nënkryetarja - përshëndet të pranishmit dhe vazhdon takimin pasi që Kryetari ka një agjendë tjetër.

Avni Bytyqi - siç raportoj edhe komandanti, çështja e vjedhjes së fundit na ka shqetësuar të gjithëve dhe si rekomandim le të del që policia të jenë më vigjilent edhe pse janë dhe nuk ka vërejtje por bashkëpunimi në mes policisë dhe qytetarëve tregon sukses.

Rekomandim: Të jetë bashkëpunimi në mes policisë, Komunës dhe qytetarëve.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 3. Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;

Nënkryetarja - jemi në prag të festave të fundvitit dhe apeli ynë është që të festohet në mënyrë të dinjitetshme.

Avni Bytyqi - Siq tha edhe Kryetari ne nuk mund të ndalojmë shitjen dhe përdorimin e tyre,atëherë ne si KKSB dhe si institucion komunal kemi për obligim që ta largojmë nga pjesa e qytetit aty ku paraqet rrezik dhe ku është frekuentimi më i madh i qytetarëve që të mos lejohet shitja e mjeteve piroteknike dhe njëkohësisht edhe shpërthimi i tyre. Andaj ne do të dalim me një rekomandim.

Rekomandim: nga data 13.12.2023 deri më date 03.01.2024 të bëhet shitja e mjeteve piroteknike në lokacionin te tregu javor,në periferi të qytetit.

Bashkim Gashi - në lidhje me këtë stacioni policor ka vite të tëra që përpilon plane operative në bashkëpunim me inspektoratet e Komunës së Suharekës bazuar ne ligj në drejtim të ruajtjes së paqes dhe sigurisë së përgjithshme në komunitet.

Nënkryetrja - a ka ndonjë propozim tjetër?

Avni Bytyqi - kam edhe një rekomandim.

Rekomandim: Për festat e fundvitit të festohet me zemër dhe jo me armë.

Nënkryetarja - i hedh në votim rekomandimet?

Aprovohen rekomandimet

Pika 4. Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tonë përdorin substanca narkotike;

Nënkryetarja - kjo është një temë jashtëzakonisht e ndjeshme e shoqërisë ku fatkeqësisht ka të rinjtë tonë që dyshohet se po përdorin mjete narkotike. Ne si institucione komunale kemi bërë fushata të ndryshme vetëdijësuese, qoftë nëpër shkolla apo qoftë edhe prej policisë që vazhdimisht mbajnë ligjërata për vetëdijesimin kundër këtyre dukurive negative. Nëse ka dyshime nga gjithë qytetarët por edhe ju si anëtar të KKSB-së,është mirë që ta diskutojmë këtë çështje dhe bashkërisht ta bëjmë një zgjidhje.

Bashkim Gashi - unë mendoj që edhe pse në Suharekë situata në këtë drejtim është në rregull për shkak se ne reagojmë me të gjitha kapacitetet tona inteligjente hetimore,operative në parandalim dhe reagim ku punojmë si një mekanizëm në parandalimin e dukurive negative. Ne vazhdimisht mbajmë ligjërata të ndryshme për vetëdijesimin e të rinjve por mendoj që duhet si një trup bashkëpunues të japim mendime dhe të investojmë në kulturë,në sport dhe shkencë.

Halim Shehu - Është mirë që familjarët të ndikojnë te edukimi i fëmijëve të tyre dhe mundësisht të mbahen ligjërata nëpër shkolla edhe pse s'besoj që kanë mungu dhe të bëhen vazhdimisht spote të ndryshme për dëmet e njerëzve të cilët mirren me këto dukuri negative,si droga,alkooli etj.Edhe ne si bashkësi islame këto dukuri i luftojmë.

Habibe Bytyqi - Drejtori i Arsimit nuk qenka por unë kisha pas dëshirë që drejtori të na jap një lloj raporti se si qëndron çështja nëpër shkolla për shkak se konsideroj që fëmijët që janë nëpër shkolla janë kategori më e rrezikuar e kësaj çështje. Nëse ka raste të tilla që Drejtorja ka has gjatë punës ndoshta mund të del dhe një rekomandim në këtë çështje,që policia bashkë me shkollat të ushtrojnë një kontroll personal,çoftë nëpër mjetet e transportit që i kanë nxënëset po ashtu edhe nëpër klasa përmes kujdestarëve.

Nënkryetarja - ne e kemi edhe takimin e bordit me drejtorët e drejtorive komunale dhe nuk kemi ndonjë rast që është deklarua por kjo nuk do të thotë që ne të shlirohemi. Unë edhe vet kam qenë mësimdhënëse dhe një përgjegjësi të madhe e ka dhe kujdestari i klasës. Kur kemi pas dyshime, ne vazhdimisht i kemi kontrollu nxënësit dhe qantat e tyre për mos me ardhë deri te më e keqja.Një ndihmesë është edhe nga qytetarët në identifikimin e këtyre vendeve. Do të vazhdojmë me ligjërata të ndryshme dhe t'ju qëndrojmë afër fëmijëve.

Rozeta Jahaj - është shumë e saktë që institucionet arsimore,institucionet shtetërore luajnë një rol të madh se si me formu një individ por unë besoj që fëmijët më shumë se sa dëgjojnë,imitojnë. Gjanat që ata i shohin,i praktikojnë dhe kështu një rëndësi të madhe e ka familja. Nëse një duhanpirës e praktikon para një fëmije sepse zakonisht ne s'kemi arrit në nivelin e shoqërive që mos me i diskutua as temat e ndjeshme para fëmijëve e sidomos me i praktikiu dukuritë negative që ne i kemi. Besoj që para se me shku në shkollë mësuesi ma i mirë është prindi. Si rekomandim le të jetë që çështjet të diskutohen në shkollë por fillimisht të diskutohet brenda familjes. Ne mësimdhënësit nuk është e mundur për një orë me ia

kontrollua çantën dhe me mbajte mësimdhënie efektive. Duhet të gjithë si shoqëri me bashkëpunua për me nxjerr një individ të suksesshëm dhe të shëndosh.

Bashkim Gashi - e keqja e fëmijëve rezulton kur tri segmente bashkëpunojnë me njërin tjetrin sepse ekziston trekëndëshi i krimit. Së pari është mungesa e kujdestarit për të cilën ju folët. Fëmija ynë vazhdimisht duhet të përkrahet nga kujdestari, që nga shtëpia, në rrugë dhe në institucionin shkollor. Kujdestari janë prindërit dhe kujdestari i dytë është mësimdhënësi. Fëmijët tanë janë duke i edukuar interneti, telefoni, kafenetë. Jo çdo gjë në internet është e mirë. Duhet me ia kanalizimi energjinë e fëmiut dhe me ia bërë një orar dhe kjo duhet të shkojë në mënyrë kolektive.

Nënkryetarja - përgjegjësia është e përbashkët dhe duhet filluar nga familja por përgjegjësi kanë edhe shkollat sepse fëmiju pjesën më të madhe të kohës e kalon në shkollë. Të bëhemi bashkarisht që ata të jenë në rrugën e drejtë.

Halim Shehu - asnjë prind nuk ka dëshirë me pas fëmijën e vet në rrugë të gabuar. Andaj kujdestari i klasës me nxënës në bashkëpunim me policinë mund të verifikojnë njerëzit të cilët hyjnë.

Avni Bytyqi - Sa kam informacione, në kuadër të shkollave të mesme janë thmeleu grupet punuese për të identifikuar nxënësit të cilët dyshohet që përdorin substanca narkotike. Nga takimi i KKS-së vitin e kaluar kanë dalë rekomandime të cilat i kanë zbatu organet kompetente dhe Komuna jonë ka tregu rezultat. Në takimin e fundit për Politikë dhe Financa janë ngritur shqetësime që nëpër shkollë po dyshohet që nxënësit kanë nëpër çantat e tyre armë të ftohta. Njëra nga kërkesat e një mësimdhënësi në shkollën e Gjinocit, anëtar në KPF ka qenë që policia të shkojë në shkollë. Mirëpo policia nuk e kanë këtë të drejtë që të hyjnë në kuadër të shkollës dhe të kontrollojnë nxënësit. U përmend që kompetenca është e kujdestarit brenda shkollës ndërsa jashtë shkollës është një rekomandim i imi, që të vazhdojmë me avazin e vitit 2019 kur policia vazhdimisht i ka kontrolluar autobusët në vajtje-ardhje të nxënësve.

Rekomandim 1: Nëse dyshohet që në ndonjë vend përdoren substanca narkotike, të raportoni në policinë e Kosovës.

Rekomandim 2: Policia e Kosovës të vazhdojë të dalë në mbrëmje dhe të kontrollojë autobusët të cilët i bartin nxënësit nëpër lokacionet e tyre ku banojnë.

Herolinda Zenelaj - pajtohem me mendimin e Rozetës por unë mendoj që nuk është problemi vetëm te fëmija ose vetëm te një familje sepse nuk besoj që ka prind që e rrit një fëmijë për me taku me persona të gabuar dhe nuk ka një mësimdhënës që don me dalë në një nivel shumë të ulët prej një shkolle. Si rekomandim unë mendoj që duhet me u kontrollu edhe vendet rreth shkollave sepse fëmijët nuk janë të vetëdijshëm për veprimet e tyre që i bëjnë por ka edhe persona të rritur që i shfrytëzojnë fëmijët. E kemi diskutuar mbledhjen e kaluar me komandantin që ekzistojnë objektet e vjetra, e sidomos te gjimnazi “Jeta e Re” e po ashtu edhe shkolla në Mushtisht. Prej vitit të kaluar sa janë shtu kontrollet e policisë në ato vende?

Bashkim Gashi - policia vepron më së miri profesionalisht kur është në rroba civile por jo çdo herë. Ne e kemi rritur intensitetin e aktivitetëve tona. Siq thashë dhe më herët, ne e kemi përgjegjësi kolektive.

Nënkryetarja - ju e dini që shumë lokale janë mbyllur me vendim të Kryetarit për shkak të dukurive të këqija. Siguria në shkollë është rritur por jashtë shkollave nuk është përgjegjës as drejtori dhe as kujdestari. Shumë ka ndikim kur një veturë e policisë sillet rreth shkollës ose parkohet.

Avni Bytyqi - me rekomandimet që unë i mora edhe nga mendimet e juaja do të dalim:

Rekomandim 1: të bëhet kontrollimi i vendeve ku frekuentohet më së shumti nga ana e nxënësve dhe kontrollimi i nxënësve në autobusë që bëjnë vajtjen dhe ardhjen e nxënësve shtëpi-shkollë dhe shkollë-shtëpi, sidomos në mbrëmje.

Rekomandim 2: të njoftohen policia e Kosovës për vendet ku dyshohet se të rinjtë tonë po përdorin substanca narkotike apo dukuri negative.

Nënkryetarja - i hedh në votim rekomandimet?

Aprovohen rekomandimet

Pika 5. Masat për parandalimin e lëmoshë-kërkuesve;

Nënkryetarja - ne si Komunë nuk kemi raste të rënda sociale. Është pak e ndjeshme kur i shohim që kërkojnë për të sëmurët por nuk e besoj që të gjithë e kanë gjendjen dhe ndoshta janë edhe të manipuluar prej dikujt. Është me rëndësi me i identifikua se kush janë këta persona sepse ne e dimë që nuk janë të Komunës tonë.

Bashkim Gashi - kërkimin e lëmoshës më të besditshme në rende publike e sanksionon ligji për rendin dhe qetësinë publike që personi i cili kërkon lëmoshë në vende të caktune dhe nuk është shtetas i RKS-së, të dëbohet në vendin nga ka ardhur. Në zonën tonë kemi fare pak dhe ata janë persona që vin nga zonat tjera.

Halim Shehu - te ne vijnë njerëz me nevoja të ndryshme e mbi të gjitha rastet e sëmundjeve. Unë kërkoj nga komandanti që ditëve të premtë zakonisht të xhamia e Suharekës të frekuentojnë në mënyrë civile sepse po i shqetësojnë njerëzit që vijnë në xhami. Kemi raste edhe nëpër fshatra.

Nënkryetarja - për rastet e sëmundjeve edhe Komuna dhe Drejtoria e Shëndetësisë e ka një buxhet të veçantë për ndihmën e rasteve të ndryshme, sëmundjeve, sociale etj.

Bashkim Gashi - Atë që e sheh dhe e dëgjon policia ka me reagu por është kjo dukuri sepse në faktorët si kisha, xhamia, teqja në mënyrë tradicionale i ka ndihmu njerëzit dhe faktikisht vet sjellja e tyre i josh dhe i bje aty.

Rekomandim: policia të bëjë verifikimin se nga cili rajon po vijnë dhe për çfarë arsye vijnë.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin?

Aprovohet rekomandimi

Takimi përfundoi: 11:15

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj